



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe të nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008, dt. 4 qershor 2008), neni 2 dhe neni 8 të Ligjit për financat e pushtetit lokal, nr. 03/L-049 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosova, nr.27/15, qershor 2008), neni 34, paragrafi 34.1, shkronja c të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të datës 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2019, miratoi këtë

R R E G U L L O R E
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TARIFA,
NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE, 01. NR. 110-2782, DT. 02.12.2011

Neni 1

1. Neni 2, paragrafi 5 i Rregullores bazike, nënparagrafi 5.2 ndryshohet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:
- 5.2 Lirohen nga pagesa e taksës automjetet që janë në pronësi të:
 - a) Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, vetëm për automjetet e zjarrfikësve;
 - b) Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, vetëm për automjetet e ndihmës së shpejtë;
 - c) Organizatës së Kombeve të Bashkuara apo cilitdo organ të saj, përfshirë këtu agjencitë dhe misionet e specializuara të saj;
 - d) Bashkimin Evropian, apo cilitdo organ të tij, përfshirë këtu agjencitë dhe misionet e specializuara të tij;
 - e) Forcave Shumëkombëshe në Kosovë: KFOR, ICO, EULEX etj.;
 - f) Përfaqësive dhe konsullatave të akredituara nga Republika e Kosovës dhe
 - g) Personave të verbër.

Neni 2

1. Neni 2, paragrafi 5 i Rregullores bazike, pas nënparagrafi 5.2 shtohen një nën paragraf i ri, **5.2 A**, me tekstin si në vijim:



5.2 A. Të drejtën e lirimit nga pagesa e taksës për automjete motorike, e realizojnë të gjithë pronarët/poseduesit, si në vijim:

- a) Anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve dhe të të zhdukurve të UÇK-së, të familjeve të dëshmorëve të kombit, të rënë në forma të ndryshme për lirinë e vendit në periudha të ndryshme historike, dhe të familjeve të viktimave civile të luftës, vetëm për radhën e parë të trashëgimisë, në përputhje me dispozitat e Ligjit të trashëgimisë;
- b) Veteranët e luftës së UÇK-së, invalidët e luftës së UÇK-së dhe invalidët e punës.

Neni 3

Të drejtën e lirimit nga pagesa e taksës për automjete motorike, e realizojnë të gjithë pronarët/poseduesit për kategoritë tjera që parashihen me ligje të tjera e që nuk janë përmendur në dispozitat e nënparagrafit 5.2 A.

Neni 4

Secili pronar/posedues është i obliguar të paraqesë lejen e qarkullimit të automjetit dhe dokumentacionin tjetër mbështetës, me të cilën dëshmon se i përket kategorive të përmendura në nenet 1, 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01-434/01-315069/19, më 30.12.2019

KRYESUESI I KUVENDIT

Agim Kuleta

